

VENDIM
Nr.51, datë 24.6.2009

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT TË KREDIVE NË BANKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, paragrafi 2, nenit 12, shkronja “a”, nenit 22, nenit 70, pika 1 dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 127 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”, të miratuar me vendimin nr.38, datë 18.7.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 10, pas shkronjës “a” shtohet shkronja “b” me përmbajtje si më poshtë:

“b) brenda ditës së nesërme të punës të raportuesit të të dhënave, për çdo “Letër Kredi” ose “Letër Garanci” të miratuar dhe të financuar me fondet e raportuesit të të dhënave.”

b) shkronja “b” e nenit 10 rinumërohet si shkronja “c”.

c) Në nenin 16 pas pikës 1, shtohen pikat 2 dhe 3 me përmbajtje si më poshtë:

“2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, raportuesit e të dhënave, bazuar në vlerësimin e tyre dhe/ose në rregullat e brendshëm të miratuar, mund të kërkojnë informacion edhe për personat për të cilët çmojnë se janë persona të lidhur me subjektin e interesuar që aplikon për të marrë kredi.

3. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, raportuesit e të dhënave, përpara se të kërkojnë informacion dhe të dhëna nga Regjistri i Kredive, duhet të jenë autorizuar paraprakisht me shkrim nëpërmjet klauzolës së pëlqimit paraprak nga çdo “subjekt i regjistrimit” për të cilin do të kërkohej informacion apo të dhëna në Regjistrin e Kredive.”

d) Pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 16 rinumërohen përkatësisht si pikat 4, 5 dhe 6.

e) Në nenin 18 pas pikës 1, shtohen pikat 2, 3 dhe 4 me përmbajtje si më poshtë:

“2. Banka e Shqipërisë realizon faturimin mujor për raportuesit e të dhënave, lidhur me detyrimet e tyre për përdorimin e shërbimeve të Regjistrit të Kredive.

3. Faturimi i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni kryhet mbi bazën e numrit të kërtimeve të suksesshme të muajit, sipas dëftësave të debitit dhe të tarifës së miratuar nga Banka e Shqipërisë për çdo kërkesë të kryer nga raportuesi i të dhënave. Faturat përkatëse i dërgohen çdo muaj raportuesve të të dhënave.

4. Pagesa e tarifës për nxjerrjen e raportit të kredimarrësit kryhet nga subjekti i regjistrimit. Kjo pagesë kryhet në favor të Bankës së Shqipërisë pranë bankave ose degëve të bankave të huaja, në llogaritë e përcaktuara në sistemet përkatëse të pagesave me përshkrimin “Komisione për Regjistrin e Kredive”.

f) Pika 2 e nenit 18 rinumërohet si pika 5.

g) në paragrafin e dytë të “Klauzolës së pëlqimit paraprak” (aneksi 3 i rregullores), shprehja “...Banka (emri i bankës)..., zëvendësohet me shprehjen “...Banka (emri i bankës)..., / dega e (emri i bankës së huaj) / subjekti (emri i institucionit kredidhënës)...”.

h) Në “Klauzolën e pëlqimit paraprak” (aneksi 3 i rregullores), përmbajtja e paragrafit të tretë ndryshon si më poshtë:

“Autorizoj bankën (emri i bankës), / degën (emri i bankës së huaj) / subjektin (emri i institucionit kredidhënës) që, për qëllimet që përfshijnë:

1. vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;

2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën (emri i bankës),/ degën (emri i bankës së huaj)/subjektin (emri i institucionit kredidhënës); dhe/ose

3. vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit.

të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/degëve të bankave të huaja/subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave /informacionit të Regjistrat të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka (emri i bankës), / dega (emri i bankës së huaj) / subjekti (emri i institucionit kredidhënës); të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.”

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani